



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLICA E KOSOVES	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH	
Nr. Org. Org. Unit	09
Nr. Pril. Pril. No.	05-4431
Nr. fashave Bastishte	-43-
Data Date	10/06/2025
Tirësinë / a	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizije nabavke/Procurement Division

KONTRATË

SHËRBIM

Titulli i kontratës:

“Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime”

Numri i Kontratës: 206-25-2746-2-2-1/C886

Numri i Prokurimit: 206-25-2746-2-2-1

Grup i OE N.N.SH. Vizion Project ; Enggroup SH.P.K.

NUI: 810540345

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

206-25-2746-2-2-1/C866

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. Vizion Project ; Enggroup SH.P.K., K.e Diellit Bl. IV H.IV, PRISHTINË, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime me numër identifikues: 206-25-2746-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

Nr.	Grupi
1	Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

1.2 Kontrata publike do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me fillimin e punëve ndërtimore dhe përfundon pas 36 muajsh.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për kryerjen e shërbimeve do të jetë 36 muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Ministria e Shëndetësisë.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 34,700.00 €; [Tridhjetekatërmijë e shtatëqind/ Euro.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara – Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) Garancioni i ekzekutimit;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe dhe Serbe in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin ekonomik

Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	SHKELQIM OSMANI
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	DREKTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	10.06.2025	Data:	10.06.2025
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie të kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimit te mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emer të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe ne këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15 Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve,

parregullsiwe ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17 Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do

t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18 Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debítohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizuesi do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizuesi mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debítohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të

të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhet ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshhtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshhtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës

b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: Caktohet me vendim nga ZKA
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës totale të kontratës me vlefshmëri prej 37 muaj.
Parimet të përgjithshme të pagesave	16	<p>Kërkesat për pagese do të bëhen për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post).</p> <p>Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post). Pagesat realizohen proporcionalisht me punët e kryera.</p> <p>Nuk ka pagese paraprake.</p>
Kualiteti i Kontrollit	17.1	<p>Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë:</p> <p>Operatori ekonomik do të dorëzojë dëshminë e kryerjes së obligimeve të pagave të punëtorëve për muajin paraprak, me sa largu deri me datë 05 të muajit në vijim.</p> <p>Mbikëqyrja e punëve është e kushtëzuar nga realizimi i punëve nga punëkryesi. Kontrata e mbikëqyrjes realizohet proporcionalisht me kontratën e punëve, proporcionalisht edhe paguhet mbikëqyrja sipas punëve të kryera dhe nëse nuk realizohet kontrata e punëve NUK realizohet as kontrata e mbikëqyrjes. Afati i realizimit të mbikëqyrjes 36 muaj është afati orientues sipas planifikimit për realizimin e punëve, por në rast se punët zgjaten me shume, obligohet që është kontrata e mbikëqyrjes të zgjatet deri në përfundim të projektit.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	DSSH, Div. i Prokurimit dhe Dep. Ligjor në MSh.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale në Prishtinë

Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Mbikëqyrja e punëve është e kushtëzuar nga realizimi i punëve nga punekryesi. Kontrata e mbikëqyrjes realizohet proporcionalisht me kontratën e punëve, proporcionalisht edhe paguhet mbikëqyrja sipas punëve të kryera dhe nëse nuk realizohet kontrata e punëve NUK realizohet as kontrata e mbikëqyrjes. Afati i realizimit të mbikëqyrjes 36 muaj është afati orientues sipas planifikimit për realizimin e punëve, por në rast se punët zgjaten me shume, obligohet që është kontrata e mbikëqyrjes të zgjatet deri në përfundim të projektit.

Në kuadër të kontratës së punëve që do të kryhen, detyrat që kërkohen nga punekryesi dhe të cilat duhet të mbikëqyr kompania mbikëqyrëse janë:

QKMFSHU-S+P+1

Objekti i qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe shërbimi i urgjencës është projektuar dhe i është punuar dokumentacioni investivo-technik për projektin zbatues sipas gjendjes së terrenit (parcelës) të parashtruar nga investitori **Ministria e Shëndetësisë**. Trolli shtrihet në kuadër të parcelës kadastrale me nr. P-72809093-00006-3, zona kadastrale Shtime.

Në kuadër të kësaj qendre janë edhe hapësirat e gjelbërta, rekreuese, në shërbim të komunitetit të kësaj qendre, të cilat shtrihen kryesisht në oborrin e qendrës, që ofron siguri dhe privatësi. Gjithashtu, objekti gjendet në një pozitë mjaft të mirë ku ofron qasje mjaft të lehtë edhe të shpejt si për këmbësorët ashtu edhe veturat, pjesë e hapësirave të jashtme janë edhe vendparkingjet e jashtme. Përgjithësisht, arkitektura e QKMFSHU-së është unike, lehtë e lexueshme, tipike për objektet të tilla, me vëllime të lexueshme në fasadë, komunikuese mes vete dhe adaptable për situacionin. Materialet e përdorura janë bashkëkohore, të aplikuara në masë të gjerë në ndërtime të tilla.

Projekti Urbanistik

Në bazë të parametrave të përshtatur urban të dalur nga Plani Zhvillimor Komunal i Shtimes, marrëveshjeve dhe konsultimeve me investitorin, është hartuar zgjidhja urbanistike për parcelën kadastrale me nr. P-72809093-00006-3. Në kuadër të kësaj parcele është planifikuar QKMFSHU (S+P+1).

Projekti Zbatues – Sipërfaqet e objektit:

Llogaritja e sipërfaqeve të objektit (brutto) të shpërndara sipas destinimit nëpër etazha		
Suterreni	Analizat dhe diagnostifikimi	968.32 m ²
Përdhesa	Trajtimi mjekësor dhe urgjenca	999.07 m ²
Kati 1	Administratë dhe shërbimet stomatologjike	999.07 m ²
Total		2966.46
		29966.46 m²

•FUNKSIONI

QKMFSHU, sipas legjislacionit në fuqi për shëndetësi, si shërbim dhe funksion i takon Nivelit Parësor Shëndetësor, që është në kompetencë të menaxhimit dhe ofrimit të shërbimit nga nivelet komunale.

QKMFSHU (S+P+1) e ka rolin e ofrimit të shërbimit të shërbimeve parësore shëndetësore. Për këtë arsye, në kuadër të këtij objekti janë paraparë të gjitha kthinat, pajisjet mjekësore dhe inventari adekuat, që të kryhet një shërbim i tillë. Konkretisht, në kuadër të kësaj QKMFSHU ofrohen shërbimet mjekësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

•PËRMBAJTJA

Etazhiteti i këtij objekti është S+P+1, ku Suterreni dhe Përdhesa janë kate me shërbime mjekësore, ndërsa Kati 1 ofron shërbime mjekësore, dhe e përfshinë administratën. Gjithashtu, shërbimet e ngushta të QKMFESHU- së janë organizuar në nivelin e Përdhesës, si qasje direkte e pacientëve, ndërsa shërbimet mjekësore me rangim më të ulët të nevojave urgjente, janë organizuar në nivelin e Suterrenit.

Objekti i posedon dy hyrje në Suterren (hyrja në radiologji dhe laborator, hyrja ekonomike) dhe pesë hyrje në Përdhesë (hyrja kryesore në QKMF, hyrja në urgjencë, hyrja e stafit të urgjencës, hyrja për vaksinim, hyrja për staf).

-Suterreni-

Përfshin një sipërfaqe bruto prej 968.32 m², me qasje direkte nga hapësira e oborrit dhe me lidhje përmes shkallëve dhe ashensorit me Përdhesën dhe Katin 1.

Koncepti themelor i zgjidhjes së hapësirës punuese është koridori, që shërben për pranimin e pacientëve dhe si pritore e recepsion, ku kemi qasje në sektorin e diagnostifikimit, respektivisht në kthinën e rentgenit, kthinën e ultrazërit, monitorimin e rentgenit, si dhe kthinat e laboratoreve-laboratori i analizave, pranimi i pacientëve, depo e urinës, dhe laboratori bio-kimik.

Suterreni përmban hapësirën e stafit mjekësor dhe teknik, ku përfshihen shefi i laboratorit, dhoma e takimeve, depoja e materialit higjienik, rrobalarja, depo qendrore për materiale të ndryshme IT, nxenja qendrore me depo për pelet, arkivi-depo për ruajtje të gjatë, arkivi-doracak për materiale në përdorim, mirëmbajtja, garderobat për staf dhe nyjet sanitare për staf dhe pacientë.

Në këtë sektor ndodhet edhe morgu, ku trupat e personave të vdekur mbahen përkohësisht në pritje të identifikimit ose lirimt për varrim ose autopsi.

Gjithashtu, në këtë kuadër është edhe depo e barnatorës dhe farmacisti, ku bëhet magazinimi dhe kontrolli total i barnave.

Disa nga kthinat kanë qasje direkte në ndriçim dhe ventilim natyror, dhe janë të pajisura me klimatizim, ndërsa kthinat të cilat nuk kanë qasje direkte në ndriçim dhe ventilim natyror janë të pajisura me ndriçim, klimatizim dhe ventilim artificial, për kontroll dhe ndërrim të vazhdueshëm të ajrit.

Hapësira Teknike:

- Garazha e ambulancës (garazhë për dy autoambulanca),
- Gjeneratori
- Depo e bocave,
- 2x Mbetje.

Hapësira e pranimit:

- Erëmbrojtësi (hyrja në radiologji & laborator),
- Shkallët,
- Tampon Zona,
- Koridori (hapësira për pritje për 27 pacienta)

Hapësirat e diagnostifikimit:

- Sektori i Rentgenit (monitorimi, UPS, dhoma e rentgenit),
- Sektori i laboratoreve (pranimi i pacientëve, pranimi i rezultateve, laborator i analizave, laborator bio-kimik).

Hapësirat e trajtimit mjekësor:

- Ultrazëri (1 shtrat),
- Radiologu.

Morgu:

- Dhoma e morgut (frizi për 3 kufoma).

Hapësira Administrative:

- Arkivi - Depo për ruajtje të gjatë,
- Arkivi - Doracak për materiale në përdorim.

Hapësira e stafit mjekësor dhe teknik:

- Dhoma e takimeve,
- Dhomë për puntorët teknik,
- Dhoma teknike,
- Shefi i laboratorit,
- Shefi i mirëmbajtjes,
- Farmacisti,
- Nxemja qendrore- Depo për pelet,
- Depo qendrore për materiale të ndryshme - IT,
- Depo e urinës,
- Depo e barnatorës,
- Depo e materialit higjienik,
- Rrobalarje,
- Mirëmbajtja,
- Korridori.

Nyjet Sanitare:

- Nyjet sanitare për pacientë (2 WC për meshkuj, 2 WC për femra, 1 WC për persona me aftësi të veçanta),
- Nyje sanitare për puntorët teknik (1 banjo),
- Garderobë për sektorin e rentgenit, së bashku me WC,
- Garderobë për staf-meshkuj, së bashku me WC,
- Garderobë për staf-femra, së bashku me WC,
- Tush kabina.

-Përdhesa-

Përdhesa përfshinë një sipërfaqe bruto prej 999.07 m². Koncepti themelor i zgjidhjes së hapësirës është pranimi i pacientit nga urgjenca, për në koridor - në infodeskun, ku fillimisht pacienti shtrihet në pjesën e triazhimit, e cila ka kapacitet prej 3 shtretërve dhe bëhet caktimi i shkallës së urgjencës për plagët ose sëmundjen për të vendosur rendin e trajtimit të pacientit. Nëse pacienti ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme atëherë dërgohet në sallën e urgjencës, ku pacienti trajtohet në funksionet vitale jetësore, e cila ka hapësirën për monitorimin e pacientëve kur ata vendosen për monitorim në kohë të caktuar pas trajtimeve që i marrin. Nëse pacienti ka plagë të thella, dërgohet në dhomën e kujdesit ndaj plagëve e cila ka qasje direkte me sallën e urgjencës, ku kërkohet ndihmë nga profesionistët mjekësor për shërim, për të parandaluar infeksionet. Të gjitha këto kthina posedojnë pajisjet profesionale mjekësore dhe kanë një ambient të përshtatëm për punë.

Gjithashtu, në përdhesë gjendet edhe dhoma për dhënien e infuzionëve, që i ka 5 shtretër, dhe hapësirën për monitorim. Nëse pacienti ka nevojë për ndërhyrje dhe indikohet nga doktori, atëherë dërgohet në dhomën e intervenimeve të vogla për injeksione apo intervenim të ngjashëm, dhe kjo kthinë është e pajisur me një shtrat. Në vazhdim të hollit kemi ordinancat të organizuara që shërbejnë për trajtime mjekësore, si dhe barnatorja nga e cila pacientët mund të pajisen me barërat të cilat i'u nevojiten.

Në këtë hapësirë gjenden edhe dy dhoma të vaksinimit që janë të pajisura me nga një shtrat, të cilat kanë qasje direkte nga hyrja për vaksinim.

Përdhesa përmban hapësirën e stafit mjekësor, me hyrje të veçantë për staf ku ndodhen garderobat me banjo për të dy gjinitë dhe dhomat e pushimit të stafit mjekësor. Të gjitha këto kthina janë të lidhura me hollin e përbashkët.

Të gjitha kthinat kanë qasje direkte në ndriçim dhe ventilim natyror, si dhe janë të pajisura me klimatizim, për kontroll dhe qarkullim të vazhdueshëm të ajrit.

Hapësira e pranimit:

- Erëmbrojtësi 1 (hyrja kryesore në QKMFESHU),
- Erëmbrojtësi 2 (hyrja në urgjencë),
- Holli hyrës,
- Receptionsioni (për 2 persona),
- Infodesku (për 1 person),
- Shkallët,
- Tampon Zona,
- Koridori (hapësira e pritjes për 45 pacienta),
- Pritorja dhe këndi i lojërave (hapësira e pritjes për 30 pacienta).

Hapësirat e trajtimit mjekësor:

- Triazhimi (3 shtretër),
- Salla e urgjencës (6 shtretër),
- Lidhëtorja (1 shtrat),
- Dhoma për intervenime të vogla,
- Barnatore,
- Ordinancat me Paradhomë (1 shtrat),
- Dhoma për Vaksinim 1 (1 shtrat),
- Dhoma për Vaksinim 2 (1 shtrat),
- Hapësirë për dhënien e Infuzioneve (5 shtretër),
- 4x Ordinanca.

Hapësira e stafit mjekësor dhe teknik:

- Dhoma për staf,
- Dhoma e mjekëve,
- Dhoma e infermierëve,
- Dhoma teknike,
- 2x Depo,
- Koridori.

Nyjet Sanitare:

- Nyjet sanitare për pacientë (3 WC për meshkuj, 3 WC për femra, 3 WC për persona me aftësi të veçanta),
- Banjo urgjente,
- 2x Garderobë për staf-meshkuj, së bashku me WC,
- 2x Garderobë për staf-femra, së bashku me WC.

-Kati 1-

Përfshinë një sipërfaqe bruto prej 999.07 m². Ky etazh përmban pjesën administrative, si zyrën e drejtorit, zyrën e asistentit të drejtorit, zyrën për IT, dhe administratën së bashku me hapësirën për pritjen e palëve. Këto kthina kanë qasje me hollin e administratës.

Hapësira tjetër e objektit përmbanë hapësirat e edukimit dhe promovimit shëndetësorë, kthinën e koordinatorit të cilësisë, dhe kthinat teknike.

Në këtë etazh gjithashtu gjenden edhe hapësirat e shërbimeve stomatologjike, të cilat janë të ndara nëpërmes hollit nga shërbimet e tjera që gjenden në këtë etazh. Këtu gjendet ordinanca stomatologjike e cila është e pajisur me dy karrige stomatologjike, e cila ka lidhje direkte me rentgenin dentar. Në kuadër të këtij sektori gjendet edhe pritja për pacientet e stomatologjisë, dhe përveç këtyre hapësirave gjenden edhe hapësirat e stafit, garderobat për të dy gjinitë dhe nyjet sanitare për pacientë, si dhe kthina për mirëmbajtje higjienike. Të gjitha këto kthina janë të lidhura nëpërmjet hollit të përbashkët të shërbimeve stomatologjike.

Të gjitha kthinat kanë qasje direkte në ndriçim dhe ventilim natyror, si dhe janë të pajisura me klimatizim, për kontroll dhe qarkullim të vazhdueshëm të ajrit.

Komunikimi i përbashkët:

- Shkallët,
- Tampon Zona,
- Korridori,
- Pritorja për stomatologji.

Hapësira Administrative:

- Zyra e Drejtorit,
- Zyra e Administratës dhe pritja e palëve,
- Asistenti i Drejtorit,
- Dhoma e Takimeve (12 persona),
- Dhoma për IT ,
- Koridori.

Hapësira për Edukim dhe Promovim Shëndetësor:

- Koordinator i Cilësisë,
- Vizita për Nëna dhe Fëmijë,
- Dhoma për Trajner,
- Dhoma për Edukim dhe Promovim,
- Dhoma për Takime (10 persona),
- Dhoma e Trajnimeve (13 persona).

Hapësirat e trajtimit mjekësor:

- Ordinanca stomatologjike (2 karrika stomatologjike),
- Rentgeni Dentar.

Hapësira e stafit mjekësor dhe teknik:

- Hapësira për qëndrim të stafit përcjellës,
- Dhoma e mjekëve – stomatologëve,
- Dhoma e mjekëve,
- Dhoma e SISH-it,
- Mirëmbajtja higjienike,
- 3x Depo për rekuizita,
- Dhoma teknike,
- Koridori.

Nyjet Sanitare:

- 2x Nyjet sanitare për pacientë (1 WC për meshkuj, 1 WC për femra, 1 WC për persona me aftësi të veçanta),
- 2x Garderobë për stafin e stomatologjisë-meshkuj, së bashku me WC,
- 2x Garderobë për stafin e stomatologjisë-femra, së bashku me WC.

Duhet cekur se objekti i përmban projektet e të gjitha instalimeve, të hartuara në bazë të normave dhe standardeve në fuqi.

Objekti e ka të projektuar sistemin e klimatizimit për të gjitha kthinat, si dhe sistemin e ventilimit për kthinat të cilat nuk kanë ventilim natyror.

•KONSTRUKSIONI

Sistemi konstruktiv i përvetësuar i objektit është skeletor, prej shtyllave të betonit të armuar, trajeve të lëshuara të betonit të armuar, trajeve të rrafshita të betonit të armuar dhe pllakave masive prej betonit të armuar. Shtyllat janë të projektuara me dimensione të ndryshme varësisht prej pozitës që e kanë, ashtu që mos të pengojnë funksionin e objektit. Pllaka e meskateve e ka trashësinë 20 cm.

Themeli i objektit është i tipit të themelit pllakë, me trashësi prej 60 cm. Nën pllakën e themelit janë projektuar edhe pesë traje shiritore prej betonit të armuar me dimensione 90 x 300 cm, dhe pesë traje shiritore prej betonit të armuar me dimensione 60 x 100 cm. Nën themele është paraparë fillimisht të bëhet stabilizimi i terrenit me zhavor të granulatit të mesëm dhe të madh, në tri shtresa me trashësi 50 cm dhe 30cm. Gjithashtu, për shkak të rrezikut nga ujërat nëntokësore është paraparë të bëhet drenazhimi nën themele, ku trupi i drenazhës do të mbushet me zhavor të granulatit të mesëm.

Mbyllja e objektit është paraparë të bëhet me mure prej bllokave të argjilës me trashësi 25 cm, të llojit Giter.

Ndarja e hapësirave mes vete është paraparë të bëhet me mure prej bllokave të argjilës me trashësi 20 cm, dhe me blloka të argjilës me trashësi 12 cm.

Vërejtje: Përmasat e elementeve konstruktive në përgjithësi mund të lexohen në projektin për zbatim, në pjesën e arkitekturës apo edhe të llogarisë statike.

• ARKITEKTURA

Përgjithësisht është në shërbim të funksionit të objektit, ashtu që, pasi objekti ka destinim të emergjencës mjekësore, trajtohet me fasadë strukturale, ventiluese dhe atë me tulla "TARA SH048", në kombinime të veçanta.

Në përgjithësi objekti posedon linja të pastërta dhe të drejta. Arkitektura mbështetet në lojën e volumeve në fasadë, me një reflektim të një organizimi të brendshëm edhe në fasadë. Krejt kjo e bënë një objekt kompakt, me një arkitekturë lehtësisht të lexueshme dhe një objekt përgjithësisht adaptabil me situacionin.

Gjithashtu edhe përdorimi i elementeve të zdrukhtarisë është jashtë aplikimit të atyre me përmasa standarde.

SPECIFIKIMI I PUNËVE TË EKZEKUTIMIT

• PËRGATITJA E VENDIT TË NDËRTIMIT

Vërejtje:

–Punëkryesi mban përgjegjësi të plotë në lidhje me ndikimin e tij në ndërprejen e aktiviteteve në lokacionin e ngushtë. Ai në llogari të vet do të evitojë ose riparojë dëmet eventuale që mund të shkaktohen gjatë realizimit të punëve të kontraktuara konform rregullave në fuqi dhe kushteve teknike,

–Punëkryesi është i obliguar, që hedhurinat e shkaktuara gjatë punës, t'i dërgoj në deponinë e autorizuar për hedhurina,

–Vendi i ndërtimit duhet të organizohet në bazë të standardeve për mbrojtje të sigurisë dhe shëndetit publik,

–Vendi i ndërtimit duhet të rrethohet dhe sinjalizohet para se të fillojë ndërtimi,

–Të gjitha materialet dhe pajisjet e parapara me projekt duhet të kenë çertifikatën e ISO standardeve,

Fillimisht, para se të fillojë organizimi në punishte, duhet të bëhet rrethimi dhe shenjzimi i nevojshëm i punishtes sipas normave të legjislacionit në fuqi (Ligji për Ndërtim i Kosovës), me mundësi të qasjes rrugore sekondare.

Kujdes të shtuar duhet të ketë ndaj infrastrukturës nëntokësore dhe nëse hasim në te, atëherë duhet të dislokohet në një pozicion tjetër dhe të vazhdohet fondimi i objektit.

Punishtja duhet të organizohet sipas skemave standarde të organizimit të tyre, në funksion të:

-mjeteve të cilat përdoren gjatë punëve ndërtimore,

-dinamikës së punëve ndërtimore,
-mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit publik,

Gjatë organizimit të punishtes duhet të sigurohet qasja nga rrugët sekondare të automjeteve që do të përdoren gjatë procesit të ndërtimit. Këtu bën pjesë edhe qasja e zjarrfikësave, të cilët duhet të kenë qasje në dy pika, në hyrje dhe në dalje të vendit të ndërtimit. Poashtu, vendi i ndërtimit duhet të ketë qasje direkte në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, konform Ligjit në fuqi.

• PUNËT E DHEUT

Gërmimi i dheut bëhet sipas normativave për tokë me lagështi natyrore, me rrënjë të kategorisë gjeoteknike 2(GC-2) në bazë të EN 1977-1.

Duhet pasur kujdes, që nëse gërmimi me pajisje makinerike shkakton pasaktësi në dimensionet e dhëna me projekt apo e dëmton kufirin e vendit të ndërtimit, atëherë gërmimi i këtyre pjesëve duhet të bëhet më dorë.

Të gjitha gërmimet duhet të shenjëzohen, barrikadohen dhe të ndriçohen për shkak të sigurisë.

Përveç formës dhe madhësisë së themeleve, gërmimi duhet të bëhet në bazë të thellësisë së fundimit si dhe kërkesave për stabilizimin e tokës të përcaktuara nga shqyrtimet gjeomekanike të prezentuara në elaboratin gjeomekanik, i cili duhet të jetë pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik gjatë zbatimit të projektit.

Tamponi shtrohet në tri shtresa, dhe para shtrimit të tij, duhet të bëhet ngjeshja e tokës me makineri adekuate për ngjeshje: me fraksion (0-120), trashësia mesatare ~50 cm, me fraksion (0-64), trashësia mesatare ~30 cm, dhe me fraksion (0-32), trashësia mesatare ~30 cm, dhe bëhet ngjeshja e këtyre shtresave të tamponit.

Përreth objektit duhet të ndërtohen trotuar të gjerë dhe uji nga ulluqet në mënyrë të kontrolluar duhet të bartet deri te pusetat e kanalizimit.

• PUNËT E GROPËS NDËRTIMORE

Gjithashtu gërmimi i dheut për pilota bëhet sipas normativave për tokë me lagështi natyrore, me rrënjë të kategorisë gjeoteknike 2(GC-2) në bazë të EN 1977-1. Diametri i pilotave është Ø 800 mm, 12 m gjatësi secila, ku në total janë 27 copë.

Betonimi i pilotave me diametër Ø 800 mm me beton C30/37, bëhet duke bërë vibrim efektiv gjatë betonimit, si dhe lakimi, montimi i armaturës B500C, bëhet sipas detajeve të llogarisë statike.

• PUNËT E ARMIMIT DHE BETONIMIT

Përgatitja e materialit duhet të bëhet në fabrikën e betonit e që duhet të jetë në përputhje me specifikat dhe standardet. Ky proces përfshin përdorimin e kallëpeve prej druri ose çeliku për beton dhe kërkon transportin e materialeve në vend, ku kryhen veprimet e nevojshme si ngjeshja, lotimi dhe mbrojtja nga temperaturat ekstreme. Prodhimi i betonit përfshin përgatitjen e materialit në silosët e çimentos dhe aditivëve për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e betonit. Duhet të përdoret Portland Çimento PC 500 (ose me karakteristika të ngjashme). Deponimi i saj duhet të bëhet në vend të mbuluar dhe e ngritur nga toka në lartësi prej 30cm. Zhavori dhe rëra që përdoret për prodhimin e betonit duhet të jetë agregat i thyer, i pastër, të mos përmbajë materie organike më tepër se 2%, të mos ketë përmbajtje të deltinës etj. Për çdo sasi të agregatit që përdoret për prodhimin e betonit, qoftë në punishte apo në ndonjë fabrikë të betonit, kontraktori është i obliguar që më parë t'ia paraqes organit mbikqyrës diagramin e lakores së përbërjes granulometrike të fraksioneve të agregatit.

Fillimisht bëhet shtrimi i Betonit të thjeshtë / të varfër me trashësi 10cm (5cm+5cm) me beton C12/16 para betonimit të themeleve të QKMFESHU. Më pas bëhet betonimi i themeleve pllakë me trashësi 60 cm, si dhe themeleve shiritore me beton 30/37, duke bërë vibrim efektiv gjatë betonimit. Betonimi i shtyllave, trajeve, pllakave të meskatit, si dhe betonimi i shkallëve, mureve të bërthamave, të ashensorëve në suterren, përdhesë, kat dhe kulm bëhet me beton C30/37 duke bërë vibrimin efektiv gjatë betonimit.

Furnizimi, lakimi dhe montimi i armaturës B500C, bëhet sipas detajeve të llogarisë statike. Duhet pasur kujdes të shtuar në përzierjen dhe kompaktësimin e betonit. Betoni i përzier duhet t'i përgjigjet totalisht kërkesave të specifikuara në paramasë, të jetë i klasës C-30/37 (MB-30).

Gjatë betonimit duhet të përdoret vibratori (PERM vibrator), ashtu që të evitohet segregimi dhe të arrijmë një kompaktësim sa më të mirë. Frekuenca minimale e vibrimit duhet të jetë 3500 impulsa në minut.

Derdhja e betonit: bëhet brenda 30 minutave prej fillimit të përzierjes, apo për beton të gatshëm, brenda 30 minutave prej nisjes nga betoniera.

Temperatura: Betoni duhet të mbrohet nga dielli dhe nga era. Në temperaturë të ajrit mbi 32°C, agregati duhet të ketë hije dhe të freskohet me ujë. Punët e betonimit nuk do të ekzekutohen nëse temperatura e ajrit nën hije është mbi 45°C.

Kërkesat për armim: Armatura duhet të vendoset sipas pozicioneve të dhëna në projekt (planin e armaturës), ashtu që të jetë e fiksuar mirë dhe të evitohet lëvizja dhe dëmtimi eventual para dhe gjatë betonimit.

Armatura duhet të jetë e kualitetit të lartë, klasa S400-500 dhe Q500-600 për armaturën rrjetë.

Pas derdhjes, betoni duhet të qëndrojë për të fituar fortësinë e mjaftueshme. Testet e nevojshme kryhen për të verifikuar përputhshmërinë me standardet përkatëse. Vendosja dhe largimi i kallëpeve duhet të bëhet në afate të duhura kohore, në mënyrë që ekzekutimi i betonit të përputhet me dinamikën e paraparë dhe me kërkesat e projektit. Kallëpet duhet të jenë në gjendje të mbajnë peshën përkatëse, të jenë stabile dhe të shtangëta me qëllim që të mos ketë devijim në asnjërin drejtim. Kujdes të veçantë duhet kushtuar pastrimit me rastin e ripërdorimit të kallëpeve, ashtu që gjatë demontimit të mos dëmtohen elementet e konstruksionit të objektit. Në fund, kallëpet e betonit largohen dhe materiali i mbetur hiqet nga kantieri, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për pajisje, materiale, punë nga kontraktori.

Vërejtje:

–Kontraktori është i obliguar që në vendpunishte të sjell kallëpe të posaçme, kubike 20x20x20 cm apo cilindrike Ø200mm, h=200mm, për marrjen e mostrave kontrolluese, me të cilat do të sigurohet kualiteti i klasës së betonit. Mostrat merren në vend nga përzierëset, duke u zbratur në vendpunishte dhe mirëmbahen në kushte të njëjta sikurse betoni i derdhur në kallëpe. Në çdo 10-15m³ të betonit të zbratur merret nga një mostër. Marrja e mostrës bëhet në prezencë të organit mbikqyrës dhe nga përziërsja që e cakton organi mbikqyrës. Pas 28 ditëve të mirëmbajtjes, ekzaminimi i mostrave do të bëhet në laboratorin e FNAP, me shpenzime të kontraktorit.

Në asnjë mënyrë nuk pranohet që mostrat të merren në fabrikën e betonit, por vetëm në punishte.

–Kërkesat specifike për punët e lartpërmendura do të verifikohen dhe aprovohen nga mbikqyrësi i vendndërtimit.

Vërejtje:

–Armatura duhet të atestohet në laboratorin e FNAP para ekzekutimit, me shpenzimet e kontraktorit.

Në përgjithësi, betoni duhet të nivelohet sa më mirë, në mënyrë që të përfitohet sipërfaqe sa më uniforme dhe e lëmuar. Pozicionet e betonuara duhet të mbrohen gjatë shtatë ditëve pasuese prej ditës së betonimit. Metoda e mbrojtjes për ngurtësim të dëshiruar do të aprovohet nga mbikqyrësi i punishtes.

•PUNËT E MURATIMIT

Ky pozicion përcakton kërkesat për punimet e mureve, të cilat do të aplikohen në projektin e QKMFESHU-së. Billoqet e argjilës që do të përdoren duhet të testohen për peshë, qëndrueshmëri në shtypje, rezistencë ndaj ngricave, dhe përbërje të materialeve të tjera, duke u siguruar që ato të plotësojnë standardet sipas

rregullave në fuqi. Të gjitha këto teste duhet të kryhen në një laborator adekuat të miratuar nga inxhinieri. Të gjitha shpenzimet për këto teste do të mbulohen nga kontraktori.

Fillimisht duhet të bëhet hidroizolimi i sipërfaqes nën mure dhe të lihen vazhdimet 20cm, për ekzekutimin e shtresës hidroizoluese me produktet e përshkruara në projekt, e pastaj të filloj muratimi. Muratimi i mureve të jashtme dhe të brendshme bëhet me blloqe te argjilës të këtyre dimensioneve 25x20x20 cm trashësia 25cm (për muret e jashtme), 25x20x20 cm trashësia 20cm dhe 25x12x20 cm trashësia 12cm (për muret e brendshme) me llaq vazhdues 1:2:6, sipas rregullave në fuqi. Në zonat ku është planifikuar instalimi i sistemeve makinerike, elektrike në muri ose shtyllë betoni të armuar (si në banjo, WC, etj.), do të punohet muri i cili mundëson kalimin e këtyre instalimeve sipas planit të makinerisë dhe elektrikës.

Gjithashtu duhet të kontrollohen edhe dimensionet dhe se a janë të gjitha akset nën kënd të drejtë. Për lartësinë e muratimit referente është kuota ± 0.00 . Hapjet e dyerve dhe dritareve janë dhënë si masa muratore, me pozicionet e zdruckhtarisë në bazë, të cilat janë shpjeguar në skemat e zdruckhtarisë.

• PUNËT E KULMIT

Para fillimit të punës, kontraktori do të përgatisë hapësirën për punë. Pas përfundimit të izolimit në kulm dhe zona të lagështa, hidroizolimet duhet të mbrohen menjëherë nga dëmtimet mekanike dhe të mos ecet mbi to. Së pari bëhet furnizimi dhe montimi i stirodurit me trashësi 3x5 cm, pas tij vendoset estrihu $t=5\text{cm}$ i armuar me rrjetë $\varnothing 5/20\text{cm}$ me pjerrësi të drejtuar kah ullaqet. Hidroizolimi do të jetë i sistemit AQUASCUD ose ngjashëm. Sistemi i izolimit përbëhet nga: AQUASCUD 420, izolues me bazë çimentoje me dy përbërës me karakteristika të elasticitetit dhe AQUASCUD BASIC, membranë mikroporoze elastike prej polipropileni izolues me bazë çimentoje. Poashtu shtrohet edhe një produkt mbrojtës që shërben për të ruajtur sistemin e izolimit nga dëmtimet mekanike dhe nga dëmtimet e tjera. Produkti duhet të jetë ekuivalent me produktin TESUDO, që të plotësoj kriteret për të mbrojtur hidroizolimën nga dëmtimet. Produktet e sistemit të izolimit duhen të kenë Çertifikatë Prodhimi CE. Poashtu prodhuesi (fabrika) të ketë çertifikatë ISO 9001 dhe çertifikatë Ambientale. Produkti AQUASCUD duhet të ketë aftësi të mbylljes të plasariëve 1.5 mm (-10°C) UNI EN 14891 (met A.8.2). Duhet llogaritur edhe shiritat ndarës të nevojshëm që vendosen mbi shtresën e estrihut në çdo (12-20) m^2 si dhe shiritat anësor dhe këndet speciale. Pas vendosjes së hidroizolimit bëhet mbushja me zhavor drenazhues me granulat 40mm mbi shtresën mbrojtëse të hidroizolimit, me trashësi $t=$ min 15cm. Materialet izoluese duhet të mbrohen sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe të inxhinierit për të shmangur ndikimet e kushteve të jashtme të motit. Shtresat e kulmit të përgatiten dhe punohen, sipas udhëzimeve dhe planit të hartuar.

Muri i atikës, muret e jashtme, strehët e hyrjeve do të mbulohen me llamarinë me ngjyrë antracit, në mënyrë që të mbrohen nga kushtet atmosferike. Gjithashtu në objekt janë paraparë që të vendosen edhe ullaqet të punuar prej llamarinës së plastifikuar, $\delta=0,7\text{mm}$, ngjyrë antracit, ku janë të parapara të gjitha veprimet e nevojshme për këtë lloj pune, si mbajtësit e ullukve, kokat e vertikaleve, kthesat, saldimi, e të ngjashme, si dhe vendosja e shkarkuesit të ujit me të gjitha elementet përcjellëse, daljet në ullaqe kryesor. Gjithashtu punimi i konstruksionit të kulmit bëhet me trarëza nga druri me dimensione 8x8 cm në strehët e jashtme të hyrjeve të QKMF-së dhe SHU-së, si dhe strehës kryesore të objektit.

• PUNËT E SHTYLLAVE METALIKE

Në projekt janë paraparë të përdoren shtylla metalike të klasës S275, të cilat do të vendosen sipas detajeve të përcaktuara në llogaritë statike. Këto shtylla kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe stabilizimin e strukturës së objektit. Shtyllat metalike do të shërbejnë në mbajtjen e strehës së objektit të QKMF-SHU-së, duke siguruar që të ndihmojnë në shpërndarjen e ngarkesave, dhe qendrueshmërinë ndaj kushteve të ndryshme. Këto shtylla montohen në pozicionet e caktuara, duke i'u përshtatur llogarisë statike.

• SUVATIMIT DHE NGJYROSJES

Ky pozicion përshkruan materialet dhe metodat e nevojshme për punët e suvatimit, sipas projekteve të parashikuara. Suvatimi tek muret e brendshme do të bëhet me produkte të gatshme nga knaufi- MP75. Këndet do të përpunohen me profile këndore të galvanizuara. Patinimi i sipërfaqeve të mureve të brendshme bëhet me material të gatshëm (Prodhime Knaufi - MP, Renova ose ngjashëm), deri në rrafshim të plotë dhe finalizim me glet (me dy shtresa).

Ngjyrosja e sipërfaqeve të mureve në pjesën e sipërme të kthinave (deri te përfundimi i Armstrongut), në lartësi 200 cm nga tavani e poshtë (prej përfundimit të Armstrongut), bëhet me ngjyrë (Pure White) RAL 9010. Ngjyrosja e sipërfaqeve të mureve në pjesën e poshtme të kthinave, në lartësi prej 120 cm nga dyshemeja e lartë, bëhet me ngjyrë yndyrore Aerostol (Grey White) RAL 9002.

Në muret e ambienteve sanitare duhet të bëhet furnizimi me materialin të nevojshëm dhe montimi i qeramikës së cilësisë së lartë:

-banjo mashkull/femër, WC mashkull/femër, tualeti për persona me nevoja të veçanta, nën dollapët e kuzhinës në lartësi 60cm të Suterrenit.

-banjo mashkull/femër, WC mashkull/femër, tualeti për persona me nevoja të veçanta, nën dollapët e kuzhinës në lartësi 60cm të Përdhesës.

-banjo mashkull/femër, WC mashkull/femër, tualeti për persona me nevoja të veçanta, nën dollapët e kuzhinës në lartësi 60cm të Katit 1.

Pozicioni përfshinë të gjitha veprimet dhe përgatitjet e nevojshme për vendin e punës. Ngjyra dhe dizajni përcaktohen nga investitori me miratimin e mbikëqyrësit të punimeve.

•PUNËT E DYSHEMESË

Përdorimi i epoksidit për shtruarje në dysheme, duhet të bëhet sipas standardeve, të cilat i parasheh prodhuesi. Epoksi duhet t'i plotësojë kërkesat në bazë të llojit të hapësirës ku vendoset.

Punimi i nivelizimit të dyshemeve, në këtë pozicion nënkuptohet vendosja e një folie anti-kondenzuese, Stirodur, 3cm, folia PVC dhe Estrich-u ~5cm. Punimi i dyshemesë nga epoksi, dhe punimi i anësoreve nga MDF me finalizim nga epoksi bëhet në tri faza. Faza e parë punohet me bazë / primer (epoxy sealer 100, forcimi i produktit në 23 °C, për shtatë ditë, raporti i përzierjes duhet të jetë 100:40), pas bazës vazhdohet me masën rafshuese (epoxy fillseal 150, forcimi i produktit në 23 °C, për shtatë ditë, raporti i përzierjes duhet të jetë 100:20). Më tutje vendoset shtresa finale (epoxy self leveling 500, forcimi i produktit në 23 °C, për shtatë ditë, raporti i përzierjes duhet të jetë 100:40) dhe si shtresë mbrojtëse në fund vendoset poliuretani transparent (PU 600 final, është transparent, viskoziteti 300-500 Pa.s, densiteti 1.05 ±0.1 g/ml). Ngjyra e epoksidit duhet të jetë 5012 Light Blue me fluska.

Punimi në dyshemenë, shkelësen, balloren e shkallëve të brendshme, dhe punimi i anësoreve të shkallëve të brendshme me lartësi prej 7 cm, bëhet prej pllakave të granitit - Moon White Granite ose të ngjashme, të kualitetit të lartë. Pllakat duhen të jenë jo- rrëshqitëse.

Punimi i dyshemesë dhe anësoreve me lartësi prej 7cm, së deposë për boca dhe hapësirave për mbetje bëhet me pllaka qeramike me ngjyrë hiri të qelët ose të ngjashme, të kualitetit të lartë. Pllakat duhen të jenë jo-rrëshqitëse. Përdorimi i qeramikës, qoftë për shtruarje në dysheme, qoftë për veshje të mureve, duhet të bëhet sipas standardeve, të cilat i parasheh prodhuesi. Qeramika duhet t'i plotësojë kërkesat në bazë të llojit të hapësirës ku vendoset. Në përgjithësi, ngjitja bëhet më ngjites dhe fuga 3mm, të mbushura me material konsistent.

Punimi i dyshemesë së garazhave për autoambulanca dhe gjeneratorit bëhet me fer-beton, të kualitetit të lartë.

Te pllatoja e hyrjes kryesore në përdhesë do të bëhet montimi i pllakave qeramike të jashtme në mënyrë strukturale të klasës së I-rë (R 11), me trashësi 2 cm dhe me ngjyrë hiri të mbyllët ose të ngjashme. Pllakat duhen të jenë jo-rrëshqitëse dhe vendosen mbi distancera. Gjithashtu pllakat duhet t'i plotësoj ISO standardet EN 14411, me absorbim të ujit Eb≤0.5.

Të gjitha punimet duhet të kryhen sipas detajeve dhe normave teknike të parashikuara për këto lloj pune. Paraprakisht të prezantohen mostrat tek organi mbikëqyrës.

•PUNËT E PLLAFONIT

Ky pozicion përshkruan montimin e pllafonëve prej gips-kartoni me konstruksion Grid 60x60cm të sistemit konstruktiv të varur Armstrong (90cm) në të gjitha kthinat e parapara me projekt (shih Arkitekturën). Kartoni i gipsit duhet të përmbushë ISO standardet, me të dy sipërfaqet e mbuluara me gips-karton. Pllakat që përdoren në zonat që kërkojnë rezistencë ndaj lagështisë duhet të jenë prej suvaje speciale me aditivë silikoni, ndërsa ato që kërkojnë rezistencë ndaj zjarrit duhet të jenë me aditivë fibra xhami. Llojet e profileve dhe hapësirat e përdorura do të aprovohen paraprakisht nga organi mbikqyrës. Materialet e montimit duhet të jenë të galvanizuar dhe në përputhje me ISO standardet.

Të gjitha pajisjet e montimit, mbajtëse horizontale apo vertikale duhet të lyhen me komponent kundër korrozionit. Distancat dhe pikat e fiksimit për shufrat e varjes në pllafon do të vendosen në intervale 120 cm, dhe duhet të përputhen me sistemet mekanike dhe elektrike, pozicionet e instalimeve dhe mbulesave duhet të merren parasysh për të shmangur ndërlikimet me shufrat e varura dhe profilet mbajtëse.

Shufrat e varësës do të montohen me vida nga çeliku/L dhe profilet kryesore të kutisë së bartësit 4060 mm do të saldohen në intervale 120 cm.

Në fund në pllafon duhet të aplikohet shirit ngjitësi + mbushje në fugat e pllakave të gipsit. Të gjitha punimet duhet të kryhen sipas detajeve dhe normave teknike të parashikuara për këtë lloj pune. Paraprakisht të prezantohen mostrat tek organi mbikqyrës.

•PUNËT E KNAUF-IT DHE HYPERPRESSURE LAMINATED (HPL)

Sipër shtretërve të sallës së urgjencës, triazhimit dhe dhomës së infuzionit do të bëhet montimi i gips-kartonave, me konstruksion 10cm dhe lartësi 2.0m 1x pllaka KNAUF GKF apo te ngjashme në të gjitha zonat e parapara me projekt (shih Arkitekturën). Gjithashtu duhet të bëhet punimi i mureve pas shtretërve të dhomës së triazhimit, dhomës së monitorimit dhe dhomës së infuzionit, me konstruksion HPL 10cm 1x Pllakë Fundermax HPL 6 mm apo të ngjashme me lartësi 2.0m në të gjitha hapësirat e parapara me projekt (shih Arkitekturën). Në pjesën e sipërme të murit duhet montuar ndriçimi LED gjithashtu panelet duhet të jenë me ngjyra si në detalin e arkitekturës ngjyra Aerostol (Grey White) RAL 9002 (shih detajet në Arkitekturë). Të gjitha punimet duhet të kryhen sipas detajeve dhe normave teknike të parashikuara për këtë lloj pune. Paraprakisht të prezantohen mostrat tek organi mbikqyrës.

•PUNËT E TERMOIZOLIMIT

Ky pozicion përfshinë termoizolimimin e objektit duke përdorur materiale dhe metoda të ndryshme. Për Demit-fasadën, do të përdoret stiropor N4 me trashësi 10 cm, dhe do të përfshijë ngjitësin, profilet fundore të aluminit, tipllat, këndet, rrjetën rabic (PVC), dhe fasadën prej 3 mm. Ngjyroja e kësaj fasade do të bëhet me ngjyrë antracite.

- **Fasada ventiluese** - Në fasadë është përdorur edhe fasada ventiluese- sistemi me nitne 4.5cm, shtrëngimi bëhet me profile të fasadës së varur. Panelet e kompaktit Max Exterior janë laminate duomer me presion të lartë (HPL) në përputhje me EN- 438-6. Lloji EDF që prodhohen në presa laminimi nën presion të madh dhe temperaturë të lartë. Rrëshirat akrilike të dyfishta të ngurtësuara ofrojnë mbrojtje jashtëzakonisht efektive nga moti, e cila është veçanërisht e përshtatshme për ballkone me jetëgjatësi dhe veshje fasadash. Disa nga vetitë e paneleve janë: Rezistent ndaj motit EN ISO 4892-5, rezistent ndaj rrezeve ultra vjollce EN ISO 4892-3, rezistent ndaj breshërit, rezistent ndaj goditjeve EN ISO 178, rezistent ndaj përkuljes EN ISO 178, rezistent ndaj ngricave dhe rrejtësive, ngarkesa konstate e temperaturës -80 °C deri +80 °C. Përzgjedhja e ngjyrave është e paracaktuar sipas arkitekturës dhe konsultimeve me investitorin siç parashihet në projekt.

Do të përdoren materialet HPL Fundermax me konstruksion 10 cm, pllaka Fundermax HPL 6 mm, dhe lesh guri me trashësi 8 cm. Ngjyra e përdorur do të jetë 0663 Reseda Green NT.

- **Fasada me tulla** - Tulla e cila është përdorur në objektin e QKMFSHU-së është "TARA SH048". Rripat e tullave janë tulla të bëra nga çimento, agregate të imëta dhe aditivë, që plotësojnë kërkesat më të larta për forcë të lartë, rezistencë ndaj lagështirës, rezistencë ndaj ngricave dhe qëndrueshmëri ngjyre. Dendësia e tyre është 1795.4 kg/m³, pesha e thatë 0.43 kg per tullë, absorbimi 227 kg/m³, absorbimi i ujit 6-8%, kurse përmasat e paketimit janë 38x 22x 70 cm. Edhe pse është prodhuar sipas një standardi specifik për

beton të përforcuar, këto tulla mund të klasifikohen si ekuivalente me një tullë balte të klasës F.L. pra rezistent ndaj ngricave me effloreshencë të ulët.

Tullat në termoizolim ngjiten me anë të ngjitësit Dast DW 3000, i cili është për:

-Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.

-Për ambiente me lagështi.

-Punueshmëri e mirë.

-Për vendosjen e pllakave qeramike, graniti dhe porcelani në sipërfaqe të forta

-Për vendosjen e pllakave qeramike, graniti dhe porcelani në suva nënshtresa pas aplikimit të astarit.

-Për vendosjen e pllakave qeramike, graniti dhe porcelani në sipërfaqe pllaka ekzistuese.

-Për vendosjen e pllakave qeramike, graniti dhe porcelani mbi nënshtresa me ngrohje në dysheme.

DW 3000 klasifikohet si C2TE

S1 sipas standardit EN 12004,

C - bazament Ce,

2 - forcë ngjitëse e lartë,

T - rezistencë ndaj rrëshqitjes

E - koha e zgjatur e përpunimit.

Sipas standardit EN 12002, ai klasifikohet si S1 - shumë fleksibil.

Për fasadën me tulla, do të përdoren tullat Gray and White (Tara SH048) me përmasa 20.7x6x2 cm ose të ngjashme, së bashku me stiropor N4 me trashësi 10 cm, të cilat do të montohen mbi një konstruksion metalik me të gjitha elementet e nevojshme, përfshirë profile mbajtëse vertikale dhe horizontale. Përpara fillimit të punës, mostrat e materialeve duhet të paraqiten për miratim nga organi mbikëqyrës dhe projektuesi, sipas detajeve në arkitekturë.

•HIDROIZOLIMI

Ky pozicion përfshinë përdorimin e materialeve dhe metodave për hidroizolim të pllakës së themelit, themeleve shiritore dhe mureve të jashtme të suterrenit. Ekuivalent me "tepihun" VOLGRIP LH, i cili aplikohet në forma role dhe vendoset njëra mbi tjetrën çdo 10 cm. Ky izolues argjilor i paraderdhur me vetlidhje me betonin ka avantazhin se mund të instalohet edhe në kushte lagështie dhe ka ka bymim të volumnit deri në 16 herë.

Ky material duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Qëndrueshmëri ndaj tërheqjes sipas UNI EN ISO 10319 > 8,5 kN/m.

- Koeficienti i përshkueshmërisë sipas ASTM D 5084 < 5×10^{-9} cm/s.

- Produkti duhet të ketë Çertifikatë Prodhimi CE dhe prodhuesi të ketë çertifikatë ISO 9001 dhe çertifikatë Ambientale.

Përveç kësaj duhet të kryhet edhe hidroizolimi i nyjeve sanitare me hidroizolim të ftohtë. Materialet hidroizoluese të përmendura në paramasë duhet të jenë të atestuara para se të vendosen. Punimi i hidroizolimit të dyshemesë dhe banjove duhet të respektojë kërkesat e prodhuesit lidhur me temperaturën e punës, mbishtresimin, përpunimin e detajeve të lidhjeve etj.

Në hidroizolim të pllatores së jashtme të përdhësës, fillimisht vendoset një shtresë vet-nivelizuese "BI MORTAR LEVELLING SEAL". Pas vendosjes së shtresës vet-nivelizuese vendoset shtresa e hidroizolimit "PLASTIVO 180" me rrjetë "XNET" (Volteco apo të ngjashëm). PLASTIVO 180 është një shtresë e papërshkueshme nga uji, tiksotropike dhe fleksibël e modifikuar polimer me dy komponentë, me CORE CURING TECHNOLOGY e bazuar në lidhës shumë reaktivë për ngurtësim efektiv edhe në kushte temperaturash të ulëta dhe mbështetëse pjesërisht të lagështa. Në pozicion përfshihen të gjitha veprimet e nevojshme për këtë lloj të punëve.

• PUNËT E DYERVE DHE DRITAREVE

Të gjitha veçoritë teknike për dyer, dritare duke i përfshirë menteshen, dorezën tërheqëse, si dhe mekanizmat e tjerë, do të jenë të ndryshme në varësi të derës dhe përdorimit. Të gjitha pozicionet për këto janë dhënë në pjesën e paramasës dhe pjesën e skemave të zdrucktarisë.

-Dritaret punohen prej profileve nga Alumini SMARTIA M110000 (gjerësia e kornizës=62.5 mm), të prodhuesit Alumil ose të ngjashëm, me tre nivele llastiqesh EPDM (UF 1.6 W/m²K). Xhami duhet të jetë 6 mm (xham i kalitur, solar, 4 stinorë) + 14 mm (ajër 100%, argon 90%) + 6 mm (xham) + 14 mm (ajër 100%, argon 90%) + 4 + 2 + 4 mm (LOW-e /xham sigures me folie), të pajisura me mekanizëm kualitativ për hapje-mbyllje perimetrale. Ngjyra e profilit të aluminit duhet të jetë antracite. Është obligim i punëkryesit që matjet e gabariteve të dritareve të bëjë para prodhimit, në menyre që të shmangen gabimet eventuale. Paraprakisht të prezantohen mostrat e lidhjeve të qosheve dhe të materialit tek organi mbikqyrës.

-Dyert e hyrjeve dhe dyert e depove të jashtme duhet të punohen prej profileve të aluminit me ngjyrë antracite, të kualitetit të lartë, të pajisura me mekanizëm kualitativ për Hapje-Mbyllje.

-Dyert kundër zjarrit duhet të jenë rezistentë ndaj zjarrit dhe tymit deri në 90 min, të kualitetit të lartë, të pajisura me mekanizëm kualitativ për Hapje-Mbyllje. Dyert duhet të jenë të çertifikuara sipas standardit evropian EN 1634-1, dyer një-krahëshe dhe dy-krahëshe dhe me xham rezistent ndaj zjarrit, në pjesën e sipërme të derës (shih skemën e zdrukthtarisë).

- Trashësia e derës është 22-24 mm, dhe pjesa e jashtme e saj është e prodhuar nga fleta të çelikut të dyfishta 0.8mm, kurse pjesa e brendshme është shtresë e dendur nga materiali kundër zjarrit.
- Korniza është e punuar nga fletat e çelikut 1.5 mm,
- Cilindër i sigurisë,
- Mentasha të dyfishta,
- 28 mm gomë mbyllëse që zgjerohet në raste të zjarrit,
- Etiketa metalike që tregojnë certifikimin e derës,
- Të mveshura me materiale ekologjike me bazë uji, ngjyra standard RAL 7035.

Paraprakisht të prezantohen mostrat tek organi mbikqyrës.

-Dyert e brendshme duhet të jenë prej MDF të bardhë RAL 9010, të kualitetit të lartë, të paisura me mekanizëm kualitativ për Hapje-Mbyllje. Dyert duhet të kenë 3 bagllamë dhe të jenë të plastifikuara me ngjyrë të bardhë, pa gravura. Pjesa e poshtme e dyerve duhet të vishet me material inoxi (INOX AISI 430) me lartësi prej 20cm në të dyja anët. Paraprakisht të prezantohen mostrat tek organi mbikqyrës.

-Dyert e brendshme (Sanitareve: WC, Banjo; Garderobave; UPS-it) duhet të jenë prej MDF të bardhë RAL 9010, të kualitetit të lartë, të paisura me mekanizëm kualitativ për Hapje-Mbyllje. Dyert duhet të kenë 3 bagllamë dhe të jenë të plastifikuara me ngjyrë të bardhë, pa gravura. Pjesa e poshte e dyerve duhen të vishen me material inoxi (INOX AISI 430) me lartësi prej 20cm në të dyja anët poashtu duhet të ketë një hapje për vendosjen Grilës me brisole alumini me dimensione 35x50cm për ventilim. Paraprakisht të prezantohen mostrat tek organi mbikqyrës.

-Dyert rrëshqitëse ASSA ABLOY SL500 ose të ngjashme, duhet të jenë të pajisura me ndalesa xhami me pjerrësi 45 gradë për të parandaluar grumbullimin e pluhurit. Montuar në brendësi të ambienteve (Të gjitha pozicionet për to janë dhënë në pjesën e paramasës dhe pjesën e skemave të zdrukthtarisë) me një mekanizëm hapje-mbyllje cilësor. Dyert me dimensione 129.22x260 cm dhe 121.92x260 cm duhet të kenë access control me buton.

• PUNËT E GARDHIT

Tek punët e gardhit, përfshihet punimi i gardhit metalik sipas modelit standard. Ky model përfshin profile vertikale të vendosura çdo 12 cm, që ka një ndarje të rregullt. Lartësia totale e gardhit është 90 cm, dhe është e parashikuar që të montohet në dy zona specifike: në pjesën e shkallëve të brendshme dhe mbi garazhën e jashtme. (Shih arkitekturën)

Në pjesën e shkallëve të brendshme, gardhi metalik do të ofroj mbrojtje dhe siguri të shtuar, duke parandaluar çdo rrezik të mundshëm për ata që përdorin shkallët dhe do të ofroj në një pamje më të pastër dhe të organizuar të hapësirës së brendshme.

Në pjesën e jashtme, mbi garazhë, gardhi metalik do të krijojë një ndarje të sigurt, meqenëse kemi denivelim të terrenit. Ky gardhë është projektuar për të qenë i qëndrueshëm ndaj kushteve të ndryshme atmosferike dhe për të ruajtur cilësitë e tij në një periudhë më të gjatë.

Gjithashtu në objekt është paraparë të vendoset edhe gardhi/anësoret prej drurit brenda hapësirave të objektit, përgjatë mureve perimetrale të koridoreve, në lartësi prej h=90 cm nga dyshemeja dhe me trashësi max. 15 cm.

• PUNËT E PARMAKËVE TË DRITAREVE

Parmakët e dritareve përfshijnë dy komponentë të ndryshëm. Për pjesën e jashtme, parmakët do të kenë një gjerësi prej 24 cm dhe do të jenë të prodhuar nga alumini me ngjyrë antracit, duke përfshirë anësoret e nevojshme për mbështetje. Në anën tjetër, parmakët e brendshëm do të jenë të bërë nga mermeri në ngjyrë të bardhë, me një gjerësi prej 12 cm dhe trashësi prej 2 cm.

• PUNËT E FASADËS STRUKTURALE DHE GJYSËM-STRUKTURALE

Fasada e këtij objekti është dizajnuar si kombinim i funksionit dhe estetikës, duke ofruar një ambient të përshtatshëm si për pacientët ashtu edhe për stafin. Elementet janë të zgjedhura për të krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe mikpritëse, duke respektuar të gjitha standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes. Në këtë projekt janë të përfshira:

Fasada sturkutrale dhe gjysëm strukturale

- **Fasada strukturale** do të realizohet duke përdorur profile alumini SMARTIA M6 (me gjerësi të dukshme të jashtme = 55 mm), nga prodhuesi Alumil ose të ngjashëm. Këto profile kanë elemente mbajtëse xhami ose silikon strukturor, që kanë një vlerë të transmetueshmërisë termike (UF) që varion nga 1.6 W/m²K, përshkueshmëri të ujit R7 dhe rezistencë ndaj ndikimeve të jashtme RE 1200.

Xhami përbëhet nga një strukturë me disa shtresa:

- 6 mm xham i kalitur, solar, 4 stinorë,
- 14 mm hapësirë e mbushur me ajër 100% dhe argon 90%,
- 6 mm xham,
- 14 mm hapësirë e mbushur me ajër 100% dhe argon 90%,
- 4 + 2 + 4 mm LOW-e /xham sigurues me folie,

Të gjithë xhamat do të jenë të pajisur me mekanizëm cilësor për hapje dhe mbyllje. Në dispozicion janë tri lloje xhami: transparent, jo-transparent (i zalluar) dhe xhami me ngjyrë Pastel Green RAL 6019. Ngjyra e profileve të aluminit do të jetë antracit. Dyert e hyrjeve kryesore duhet të jenë rrëshqitëse elektrike DC24V. Dyert duhet montuar në pjesën e jashtme dhe të brendshme të zonave me kontrollues mikroprocesor (automatik) me reagim hapje/mbyllje prej 0,7s. Është obligim i punëkryesit që matjet e gabariteve të fasadës strukturale ti bëjë para prodhimit, në menyrë që të shmangen gabimet eventuale. Paraprakisht të prezantohën mostrat e lidhjeve të qosheve dhe të materialit tek organi mbikqyrës.

- **Fasada gjysëm-strukturale** do të realizohet duke përdorur profile alumini SMARTIA M6 (me gjerësi të dukshme të jashtme = 55 mm), nga prodhuesi Alumil ose të ngjashëm. Këto profile kanë elemente mbajtëse xhami ose silikon strukturor, që kanë një vlerë të transmetueshmërisë termike (UF) që varion nga 1.5 deri në 3.3 W/m²K, përshkueshmëri të ujit R7 dhe rezistencë ndaj ndikimeve të jashtme RE 1200.

Xhami përbëhet nga një strukturë me disa shtresa:

- 6 mm (3+3) xham me folie
- 14 mm hapësirë e mbushur me ajër 100% dhe argon 90%,
- 4 mm xham,

Të gjithë xhamat do të jenë të pajisur me mekanizëm cilësor për hapje dhe mbyllje. Në dispozicion janë tri lloje xhami: transparent dhe jo-transparent (i zalluar). Ngjyra e profileve të aluminit do të jetë antracit. Është obligim i punëkryesit që matjet e gabariteve të fasadës strukturale ti bëjë para prodhimit, në menyrë që të shmangen gabimet eventuale. Paraprakisht të prezantohën mostrat e lidhjeve të qosheve dhe të materialit tek organi mbikqyrës.

• DHOMA RTG

Në projekt është paraparë të përfshihet edhe dhoma RTG-nit, së bashku me monitorim. Punimi i dyshemesë Epokside Antistatike, me trashësi 3.2 mm, tip "Conduct", në dhomat e RTG-nit, përfshin disa hapa. Fillimisht, vendoset një rrjetë me shufra bakri CU (40x40 cm), e lidhur për tokëzim. Dyshemeja ka disa shtresa: një shtresë bazë epokside mbi estrich StoPox GH 205, një shtresë tjetër epokside e përzier me rërë kuarci StoPox GH 205, dhe një shtresë epoksidi dy komponentësh me grafit dhe shirita bakri deri në tokëzim StoPox WL 110. Më pas aplikohet një shtresë epoksidi dy komponentësh konduktiv 3.2 mm me çipsa dekorativë sipas dëshirës StoPox KU 611, dhe përfundon me një shtresë të politures për mirëmbajtje StoDivers P110. Ky pozicion duhet të realizohet në dhomën kryesore RTG dhe dhomën dentale (RTG).

Dyert duhet të kenë një shtresë plumbi 2 mm në tërë sipërfaqen e tyre. Dera duhet të jetë të paktën 5 cm më e gjerë se hapja në mur nga të tri anët, për të siguruar mbivendosje të shtresave mbrojtëse. Konstruksioni i derës është i bërë nga druri i lameluar me veshje alumini, ka një kornizë metalike të gjerë dhe shtresë plumbi 2 mm. Dera është me hapje manuale, ngjyra RAL9010, dhe pjesa e poshtme është e mbuluar me një shtresë të përforcuar nga INOXI (AISI 430) në lartësi 20-30 cm. Punëkryesi duhet të bëjë matjet e sakta të gabariteve të derës para prodhimit, për të shmangur gabimet. Ky pozicion duhet të realizohet në dhomën kryesore RTG dhe dhomën dentale (RTG).

Dritaret në dhomat e RTG-nit përfshin përdorimin e kornizave dhe qelqeve prej plumbi. Dritaret mundësojnë pamje teleskopike dhe janë të zhytura në flake të galvanizuar me shkallë 16 të radioaktivitetit "Jetcoat". Qelqi i dritares ka trashësi 3.2 mm dhe 85% transmetim të dritës. Të dhënat teknike për qelqin janë: trashësia 3.2 mm, pesha 6.1 kg / 0.0185 m², indeksi i thyerjes 1.76, transmetimi i dritës 85%, pika e tërheqjes 523 °C, dhe temperatura e zbutjes 673 °C.

Për materialin dhe punimin e mureve dhe tavaneve nga gips-kartoni radioprotektiv (pa plumb) me karakteristika kundër zjarrit GDF dhe mbrojtje nga rrezet radioaktive DF, përdoren pllaka SAFEBOARD DF DIN EN 520 me një konstrukcion 7.5 cm, 4 shtresor, gips-karton SAFEBOARD nga KNAUF apo të ngjashme në vendet të cilat janë të parapara. (shiko Arkitekturën). Të gjitha punimet duhet të kryhen sipas detajeve dhe normave teknike të parashikuara për këtë lloj pune. Pllakat SAFEBOARD do të montohen rreth dhomës së RTG, si dhe për ndarjen e dhomave të RTG me dhomën teknike, sipas detajeve të paraqitura në pjesën grafike. Të dhënat e pllakave janë: gjerësia 625 mm, gjatësia 2500 mm, këndet me karton HRK për brinjët gjatësore dhe SK për brinjët ballore, lloji i pllakatave sipas DIN EN 520 DF dhe DIN 18180 GKF.

Për ndarjen e dhomave të RTG-nit me pllaka të gips-kartonit KNAUF apo të ngjashme, me konstrukcion 10 cm, gjithashtu përfshihen të gjitha pajisjet e ndërtimit, termoizolimi dhe mjetet tjera shoqëruese. Të gjitha punimet duhet të kryhen sipas detajeve dhe normave teknike të parashikuara për këtë lloj të punës. Mostrat duhet të paraqiten në organin mbikqyrës.

Regjistrimi dhe matja e nivelit të rrezatimit radioaktiv në dhomat e RTG-nit me rreze X do të bëhen pas montimit nga një kompani e certifikuar për matjet e radioaktivitetit.

• PUNËT E REKLAMËS

Në punët e reklamës duhet të bëhet furnizimi dhe montimi me tekst "SHËRBIMI I URGJENCËS", me lartësi 55cm, "QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE", me lartësi 50cm, respektivisht 40 cm dhe "RADIOLOGJIA & LABORATORI", me lartësi 40cm, nga llamarinat me ndriçim dhe pleksiglas në çdo shkronjë. Reklamimi duhet të vendoset mbi fasadën me tulla përgjatë fasadës jug-perëndimore për Shërbimin e Urgjencës, të hyrja e Urgjencës, në fasadën jug-perëndimore për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, të streha e hyrjes dhe në fasadën jug-lindore për Radiologjinë & Laboratorin.

• PUNËT E ASHENSORIT

Objekti i posedon dy ashensorë, me dimensione të kthinës së ashensorit 290 cm x 230 cm. Njëri ashensor është i vendosur te shkallët kryesore dhe i lidh të tre katet (shërben si ashensor kryesor që e lidhë suterrenin, përdheshën dhe katën 1), ndërsa ashensori tjetër është vetëm në shërbim të Urgjencës

Mjekësore dhe shërben për lidhje të shpejtë të urgjencës me radiologjinë dhe laboratorin, të cilat janë të vendosura në suterren (ky ashensor e lidhë suterrenin me përdhësë).

Ashensori duhet të plotësojë këto kërkesa:

- Lloji Elektrik,
- Makineri MRL,
- Pesha mbajtëse 1275 kg,
- Nr. personat 17 (duhet të përshtaten shtretërit e urgjencës),
- Shpejtësia 1 m/ s,
- Fuqia e motorit 4.0kW +/-,
- Raporti i transmisionit 1/2,
- Numri i hyrjeve të kabinës 1,
- Numri i ndalesave 3,
- Gjerësia e pusit 2300 mm,
- Thellësia e pusit 2900 mm, vrima 1100 mm,
- Lartësia e katit të sipërm 4200 mm,
- Gjerësia / Lartësia e derës 1100x210.

• PUNËT E MBROJTJES NGA ZJARRI

Hartimi i planit për Mbrojtje nga Zjarri, për QKMFSHU S+P+1 në Shtime, është bërë duke u bazuar në një numër të konsiderueshëm të ligjeve në fuqi, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të ndryshme, të cilat direkt apo indirekt kanë të bëjnë me lëminë e mbrojtjes nga zjarri.

Në këtë projekt janë përfshirë materialet të cilat janë zjarrëduruese në mënyrë që të ofrojnë siguri në raste emergjente.

Trajtet, shtyllat, muret dhe pllakat në etazhe janë në kufi të sektorëve të zjarrit dhe kutive të zjarrit dhe janë të projektuar ashtu që nuk lejojnë lëshimin e zjarrit në hapësirat tjera. Rezistueshmëria e elementeve që duhet të jenë jodjegës (DIN 4102-del 1, klasa A1 apo A2):

- Konstruksioni bartës: RE90 (pa funksionin e ndarjes së zjarrit),
- Konstruksioni bartës: REI90 (pa funksionin e ndarjes së zjarrit),
- Konstruksioni i shkallëve (konstruksioni bartës muret e brendshme, shkallët, dyshemeja): REI 90,
- Muret e jashtme: min. EI30,
- Muret ndarëse: materiali jodjegës A1 apo A2,
- Konstruksioni i pllafonit mes etazhave: REI90, - muret, dyshemeja dhe pllafoni i hapësirës së ujësjellësit: për pjesët bartëse REI 120 / për pjesët jo bartëse EI 120.
- Muret ndarëse të kutisë së zjarrit te depotë të rezistueshëm nga zjari EI 30.

Dyert e shkallëve emergjente të cilat janë në kontakt të drejtpërdrejtë me hollin, nëpër të gjitha etazhat janë të rezistueshme ndaj tymit dhe zjarrit për 90 minuta EN 1634 - 1. Dera e pusëtës së ashensorit është nga materiali jodjegës (A1 apo DIN 4102).

Pllafonet (pllaka mes etazheve) është nga materiali jodjegës me rezistueshmëri nga zjarri min. REI90. Pllafonet e shkallëve janë nga materialet jodjegës (DIN 4102-A2; konstruksioni dhe kapëset e pllafoneve të poshtëm duhet të jenë të punuar korrekt dhe nga materialet e duhura).

Materiali mbëshjellës i mureve dhe pllafonëve nëpër vendet për evakuim (korridoret, shkallët), hapësirat energjetike si dhe në hapësirat të cilat në rast të zjarrit lëshojnë gaze helmuese, është nga materiali jodjegës DIN4102-A2.

Dyshemeja në hapësirat për evakuim (shkallët që lidhin korridorin me garazhën, hapësirat energjetike) është nga materiali jodjegës (DIN 4102 -A1).

Kanalet për ajrosje, ngrohje dhe instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë të punuara nga materiali jodjegës DIN4102-A1 apo A2.

Përveç këtyre masave në secilën etazhë, duke filluar nga suterreni e deri te etazha e fundit, është instaluar rrjeti i hidrantëve të brendshëm. Në secilën etazhë hidrantët ndodhen në hapësirën e përbashkët

të hollit kryesor, afër ashensorit dhe për çdo etazhë është nga një i tillë. Janë të projektuar hidrant muri (EURO) të përbërë, me gyp DN25, l=25 m (10+15), lidhje DN50 (DN 2"), ku në etazhën e fundit me shtypje 2.5 bar. Hidranti është i vendosur në dollap, së bashku me pajisjet përcjellëse, sipas normës EN 671-2. Rrjeti i hidrantëve të brendshëm, për funksionim adekuat, duhet t'i përmbahet kushteve si në vijim:

- Në etazhat e ulëta të vendosen diafragmat;
- Shtypja maximale të jetë 7.0 bar;
- Diametri i valvoles DN50 (DN 2") dhe diametri i gypit fleksiv 52 mm;
- Vrima e grykës të jetë 12 mm;
- Lartësia e valvoles nga dyshemeja të jetë 1.50 m;
- Stacioni i pompave të vendoset në bodrum, të sigurohet me mure zjarrëduese në afat deri 120 min dhe derë zjarrëduese në afat 120 min;
- Të montohen dy pompa (njëra rezervë);
- Kabllot të veshen me material zjarrëdues deri në 120 min;
- Të jenë të lidhura edhe me rrymë rezervë;
- Të realizohet gypi i thatë për furnizim nga jashtë prej kolektorit deri në murin e jashtëm, me diametër DN.

Gjithashtu në tampon zonën e shkallëve të brendshme gjendet oxhaku, i cili duhet të pajiset me grila gjatësore në gjysmën e sipërme të oxhakut, të cilat e sigurojnë daljen natyrale të tymit të futur në tampon zonë, në rast të shfaqjes së zjarrit në objekt.

Në dhomën e rentgenit dhe SISH-it sistemi është i destinuar për fikje automatike të zjarrit me agjent të pastër ("clean agent") FK-5-1-12. Baza për llogaritjen e agjentit për fikjen e zjarrit është standardi ISO 14520.

Sistemi për detektimin e zjarrit në dhomën e rentgenit + monitorimi përmban:

- Paneli i kontrollit
- Detektor i kombinuar konvencional optik dhe termik, i certifikuar sipas EN 54-5 dhe EN 54-7.
- Sirenë me sinjalizim optik dhe akustik, i cert. sipas EN 54 -3, 88dB.
- sinjalizues me ndriçues, që tregon fillimin e procesit të aktivizimit të sistemit për shuarjen e zjarrit, konform EN 55015, EN 61547, EN 61000-3-3, EN 61000-3-2.
- kablo për instalimin e komponentëve të sistemit të lajmërimit duhet të jetë JB-Y(ST) ST2x0.8 mm² (ose ekuivalent).

Sistemi për shuarjen e zjarrit në dhomën e rentgenit + monitorimi përmban:

- një enë cilindrike me kapacitet të mjaftueshëm e mbushur me 128 kg agjent FK-5-1-12 (*). Presioni punues 25 bar, në temperaturë 20 °C,
- valvulë solenoidi,
- valvulë me aktuator manual / pneumatik,
- manometër me ndërprerës presioni ("pressure switch"),
- tub shkarkimi, - valvulë kontrolli,
- mbajtës i cilindrit,
- hundëz shkarkimi 360° (tavani i lëshuar),
- hundëz shkarkimi 360° (në hapësirën kryesore),
- rrjeti i tubave SCH 40 me dimensione dhe gjatësi adekuate, të certifikuar sipas EN 10208-1.

Sistemi për detektimin e zjarrit në dhomën e SISH-it përmban:

- Paneli i kontrollit
- Detektor konvencional i kombinuar optik dhe termik, me bazë, i certifikuar sipas EN 54-5 dhe EN 54-7.
- Sirenë me sinjalizim optik dhe akustik, i cert. sipas EN 54 -3, 88dB.

- Sinjalizues me ndriçues, që tregon fillimin e procesit të aktivizimit të sistemit për shuarjen e zjarrit, konform EN 55015, EN 61547, EN 61000-3-3, EN 61000-3-2.

- Kablo për instalimin e komponentëve të sistemit të lajmërimit duhet të jetë JB-Y(ST) ST2x0.8 mm² (ose ekuivalent).

Sistemi për shuarjen e zjarrit në dhomën e SISH-it përmban:

- valvulë solenoidi,

- valvulë me aktuator manual / pneumatik,

-manometër me ndërprerës presioni ("pressure switch"),

- tub shkarkimi,

- valvulë kontrolli,

- mbajtës i cilindrit,

- hundëz shkarkimi 360° (tavani i lëshuar),

- hundëz shkarkimi 360° (në hapësirën kryesore),

- rrjeti i tubave SCH 40 me dimensione dhe gjatësi adekuate, të certifikuar sipas EN 10208-1.

Të gjitha materialet në mënyrë më të detajuar janë dhënë në elaboratin për mbrojtje nga zjarri.

• PUNËT E SINJALIZIMIT

Tabelat me shkrim për secilën dhomë do të realizohen me materiale plastike dhe do të kenë dimensione 15x40 cm. Tabelat do të vendosen mbi derën përkatëse të dhomave si: Receptioni, Triazhimi, Laboratore, Barnatore, Zyret administrative, Dhoma e stomatologut, Rentgeni me simbol, WC, Zhveshtore etj.

Po ashtu, montohen edhe shenjat standarde emergjente që tregojnë drejtimin e ikjes në rast emergjencash, për të siguruar orientimin e duhur në objekt.

Reklama me tekstin "RECEPSIONI" x2, "HAPËSIRA E PRITJES" x3, "INFODESKU" x1 dhe "TRIAZHIMI" x1, do të montohet në përdhësë. Ky tekst do të jetë me lartësi 20 cm, i bërë nga llamarina dhe pleksiglas për çdo shkronjë, me ndriçim të integruar. Reklama do të varet mbi tavolinën e receptionit me litar nga pllafoni.

Vërejtje:

--Pajisjet e prodhuesve të pa certifikuar me ISO dhe pa ateste të nevojshme, nuk do të pranohen.

Prokurimi: 206-25-2746-2-2-1

Nr i brendshëm:

Tituli: Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

1 Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

Kodi i tenderit: VPEN05

Data: 05.05.2025

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	01. Aneksi 1_Specifikimet Teknike të Detyrueshme.pdf
2.	02. Aneksi 2_Deklaratat nen Betim.pdf
3.	03. Aneksi 6_DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT.pdf
4.	04. Dokumentet Ligjore_Vizion Project.pdf
5.	05. Dokumentet Ligjore_Enggroup.pdf
6.	06. Deklaratat Tatimore Vjetore_Vizion Project.pdf
7.	07. Deklaratat Tatimore Vjetore_Enggroup.pdf
8.	08. Lista e Kontratave të Realizuara_Vizion Project.pdf
9.	09. Lista e Kontratave të Realizuara_Enggroup.pdf
10.	10. Lista e Stafit Profesional.pdf
11.	11. DEKLARATA E MENAXHERIT TË PROJEKTIT.pdf
12.	12. Menaxher i Projektit_Shkëlqim Osmani.pdf
13.	13. Master i Arkitekturës_Premton Gjonbalaj.pdf
14.	14. Inxhinier i Ndërtimit_Basret Selimi_FIDIC.pdf
15.	15. Inxhinier i Ndërtimitarisë Konstruktiv_Sedat Ahmeti.pdf
16.	16. Inxhinier i Hidroteknikës_Lavdim Osmanaj.pdf
17.	17. Inxhinier i Elektroteknikës_Ganimet Selimi.pdf
18.	18. Inxhinier i Makinerisë_Afrim Gashi.pdf
19.	19. Lista e Punëtoreve nga ATK_Vizion Project.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime	Pjesa II. Përshkrimi i Çmimeve.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ZAGREBIT , P.N., -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 206-25-2746-2-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. Vizion Project ; Enggroup SH.P.K., K.e Diellit Bl. IV H.IV, 10000, PRISHTINË, Kosovë

E-mail: vizionproject@yahoo.com

Personi kontaktues: Shkelqim Osmani

Telefoni: 045 222 888

Faxi:

Numri fiskal:

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

Partneri 1.

Emri i kompanisë: " Enggroup " SH.P.K.

Numri fiskal: 600317540

Vend-Selia: Vëllezrit Gërvalla Bl.8, 10000, PRISHTINË, Kosovë

Partneri 2.

Emri i kompanisë: N.N.SH. " Vizion Project "

Numri fiskal: 600278370

Vend-Selia: K.e Diellit Bl. IV H.IV, 10000, PRISHTINË, Kosovë

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 206-25-2746-2-2-1

Titulli i kontratës: Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

3. Çmimi total i tenderit është:

34,700.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.



7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime					
Nr.	Shërbimi - Punimet	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1	Mbikëqyrja profesionale e punëve ndërtimore për ndërtimin e objektit të Ndërtimit të QKMF-së në Shtime, për të gjitha fazat e punëve ndërtimore sipas Specifikimeve Teknike në DT dhe Kërkesave të obligueshme për menaxhimin-mbikëqyrjen e kontratës, si dhe në pajtim me ligjin e ndërtimit. Në kuadër të çmimit të dhënë do të përfshihen shërbimet e mbikëqyrjes profesionale për të gjitha punët e kontraktuara në kontratën e punëve ndërtimore (Objekti, Parteri si dhe punimet tjera të kontraktuar edhe jashtë parcelës së ndërtimit) dhe do të llogaritet për projektin komplet deri në finalizim.	Komplet projekti	1	€ 34,700.00	€ 34,700.00

<p>Vërejtje: Çmimi i dhënë përfshinë të gjitha shërbimet e ofruara në kuadër të mbikëqyrjes profesionale të kontratës, si dhe të gjitha tatimet dhe taksat obligative sipas legjislacionit.</p>
<p>Pagesat për ofrimin e shërbimeve të mbikëqyrjes së kontratës do të bëhen në faza, konform realizimit të përqindjes së punëve ndërtimore të aprovuara nga Autoriteti Kontraktues.</p>
<p>Kontrata e shërbimeve të mbikëqyrjes është e kushtëzuar me realizimin e kontratës së punëve ndërtimore, në rast të mos realizimit të punëve ndërtimore nuk realizohet as kontrata e shërbimeve të menaxhimit dhe AK nuk ka obligim ndaj kontraktorit.</p>
<p>Kontrata e shërbimeve është paraparë me afat 36 muaj por për sigurinë e AK afati mund të shtyhet në rast se vonohen punimet. Por meqenëse çmimi është i pa ndryshueshëm dhe oferta i për komplet projektin, OE obligohet që të kryej shërbimet edhe përtej afatit 36 muajsh të planifikuar.</p>

Identifikim i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i oe:	N.N.SH Vizion Project
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të oe:	SHKELQIM OSMANI
Nënshkrimi:	
data:	05.05.2025
vula:	


MENAXHER I KONTRATËS

Nr	Emri dhe Mbiemri	Përgatitja Profesionale	Pozicioni ne kompani	Përvoja ne vite
1	SHKËLQIM OSMANI	INXH. I DIP. I ARKITKETURËS	MENAXHER I PROJEKTIT	19 VITE

LISTA E STAFIT PROFESIONAL

Nr	Emri dhe Mbiemri	Përgatitja Profesionale	Pozicioni ne kompani	Përvoja ne vite
2	PREMTON GJONBALAJ	MASTER I SHKENCAVE NË ARKITKETURË	Projektues dhe Mbikëqyrës i Arkitekturës dhe i Çertifikuar për Auditimin e Energjisë në Ndërtesa	7 VITE
3	BASRET SELIMI	INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË – DREJTIMI KONSTRUKTIV	Projektues dhe Mbikëqyrës i Ndërtimit i Çertifikuar me FIDIC	20 VITE
4	SEDAT AHENTI	INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË – DREJTIMI KONSTRUKTIV	Projektues dhe Mbikëqyrës i Strukturës dhe i Çertifikuar për Auditimin e Energjisë në Ndërtesa	9 VITE
5	LAVDIM OSMANAJ	INXH. I DIP. I HIDROTEKNIKËS	Projektues dhe Mbikëqyrës i Instalimeve Hidroanitare dhe i Çertifikuar për Auditimin e Energjisë në Ndërtesa	19 VITE
6	GANIMET SELIMI	INXH. I DIP. I ELEKTROTEKNIKËS	Projektues dhe Mbikëqyrës i Inxhinierisë Elektroteknike	17 VITE
7	AFRIM GASHI	INXHINIER I DIPLOMUAR I MAKINERISË – DREJTIMI TERMOENERGJETIKË	Projektues dhe Mbikëqyrës i Makinerisë	24 VITE

N.N.SH "VIZION PROJECT" N.N.SH
PRISHTINE



Vizion Project
PRISHTINE
REPUBLIKA E KOSOVËS

DATA: 05.05.2025
VENDI: PRISHTINË

DEKLARATA E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

Konzorciumi i kompanive N.N.SH "VIZION PROJECT" & Enggroup SH.P.K. nga Prishtina cakton menaxher të projektit z.Shkelqim Osmani me profesion Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës për tenderin me titull :

Autoriteti Kontraktues: MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Titulli: Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime


Numri i Prokurimit: 206-25-2746-2-2-1

z.Shkelqim Osmani me pervoj pune 19 vjeqare me titull Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ka qene menagjer i mbikëqyrjes në projekte të ndryshme qe ka bërë kompania N.N.SH "VIZION PROJECT" te cilat i ka përfunduar me afat të parapar sipas autoritetit kontraktues.

N.N.SH "VIZION PROJECT"



Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës
Shkelqim OSMANI





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Vllada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESIT NE KOSOVE
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATE E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810540345

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Shkelqim Osmani B.I.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

N.N.SH. "Vizion Project"

Emri tregtar / Trgovacko ime / Commercial name


Lloji biznesit: Biznes Individual
Poslovni tip: Individualno preduzeće
Business type: Individual business

Adresa: 20, K. e D'ellit Bl. IV H, IV
Adresa: Prishtinë
Address:

Data e regjistrimit:
Datum registracije: 03/03/2008
Date of registration:

10/03/2020

Data / Date / Datum



N. Selami

Nënshkrimi / Signatüre / Pötpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10071261



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT E BIZNESEVE NE KOSOVE
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810502759

Numri Unik-Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Enggroup shtetk

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:


Nebih Gashi, Bll B6:Ob Z.K-1,lok 19
Prishtine

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

24/01/2005

24/05/2019

Data / Date / Datum



Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10030343



Garanci Ekzekutimi



Serial\ 070020070017231

Për **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

N.N.SH. Vizion Project

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Mbikëqyrja e Punëve për Projektin e Ndërtimit të QKMF-së në Shtime

të dhënë me numrin e Prokurimit.

206-25-2746-2-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

€ 3,470.00

Tre mijë dhe Katër qindë dhe Shtatëdhjetë €

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

€ 3,470.00

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen (shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

10.06.2025

deri më

13.07.2028

Lëshuar në

Dega Prishtine

datë

10.06.2025

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Agjenti: **Ajtene Pakashtica**